



DITARI MUJOR

# PRILL 2022

## MBËSHETJA PËR FERMERËT

### Kartat e naftës falas për fermerët, shpërndarja nis në kohë rekord

Skema Kombëtare për mbështetjen e sektorit të bujqësisë, e cila bashkë me shtesën në Paketën e Rezistencës Sociale kapl shifrën 3,7 miliardë lekë, këtë vit ka nisur me përpunimin e të dhënave dhe shpërndarjen e kartave në kohë rekord.

Përpunimi i të dhënave qëpas mbylljes së aplikimeve më 30 mars, ka nisur me një punë intensive të staftit të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, dhe siç nuk ka ndodhur më parë, që në javëne parë pas mbylljes së aplikimeve nisi shpërndarja e kartave të para të naftës falas për fermerët. Këtë vit ka pasur një interes më shumë se dy herë më të lartë krahasuar me vitin e kaluar të fermerëve për skemën e naftës që përdoret për punimet e mekanizuara, çka do të thotë më shumë besim tek institucionet, e që do të përkthehet me më shumë punë së bashku për një zhvillim të merituar të bujqësisë.

Ministrja Frida Krifca, duke vlerësuar rëndësinë e këtij procesi, ka dorëzuar vetë kartat e para për fermerët në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë në Durrës. Brenda muajit Prill janë përpunuar mijëra të dhëna nga aplikuesit dhe janë ndarë më shumë se 5100 karta me naftë falas për fermerët. Puna vazhdon!



### DREJT EUROPËS

#### Miratohet Ligji për Krijimin e Grupeve Vendore të Veprimit

Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin "Për Krijimin e Grupeve Vendore të Veprimit" i paraqitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ligji na përfron me politikën e Bashkimit Europian, duke mbështetur filozofinë e bashkimit e kooperimit, e duke krijuar kuadrin ligjor për veprimin e bashkimeve të fermerëve, shoqërive bujqësore, blegtorale apo të peshkimit, shoqatave mjedisore, organizatave profesionale, njësisë të qeverisjes vendore, ofruesvetë shërbimeve në komunitete, sipërmarrësve, organizatave të grave e të rinjve dhe aktorëve të tjerë lokalë, që të ndërveprojnë për interesa të përbashkëta komunitare rurale. Me këtë ligj nis zbatimi i Qasjes LEADER- një nismëeuropiane komunitare, ku GVV-të kanë fuqi vendimmarrëse, bashkëshoqëruar me instrumente financiare në grant për zbatimin e strategjive lokale.



### DIALOG ME MINISTREN

#### Vlerësimi pedagogjik mbi gripin e shpendëve: Nuk ka asnjë rrezik!

Në "Dialog me Ministren", debatin e hapur, të përmuajshëm për çështje të bujqësisë së bashku me profesorë në Universitetin Bujqësor të Tiranës, Ministrja Krifca ngriti temën e sigurisë ushqimore në rastin e gripit të shpendëve që ka përfshirë Europën e Amerikën. Profesorë veterinerë, zooteknikë, virologë, epidemiologë, më të mirët e fushës që kemi në vend, trajtuan rastin në një event të hapur për mediat, në raport me masat e marra, mësimet e përfutuara, por dhe duke iu dhënë përgjigje shkencore spekulimeve të ngritura në publik mbi efektet e gripit të shpendëve. Theksu i u vu në evitimin e keqinformimit të konsumatorit. Epidemiologët në takim theksuan se konsumatori nuk ka asnjë rrezik.



**ZGJERIMI I EKSPORTEVE**  
Krifca në Gjermani: Qëllimi ynë bujqësor i eksporteve bujqësore shqiptare

Në Berlin është zhvilluar panairi më i madh i marketimit të produkteve bujqësore në Europë me 135 shtete, ku Shqipëria është përfaqësuar me 11 nga kompanitë më të mëdha të prodhimit e përpunimit bujqësor, me mbështetjen e GIZ: "Shqipëria synon të eksportojë në tregjet më të sofistikuar të Europës. Kemi qëllim që eksportet bujqësore të arrijnë shifrën 1 miliardë dollarë", u shpreh Krifca.



**FËMIJET NË BUJQËSI**  
Mbjellja e fidanëve nga të vegjllit dhe mësimi për rrenjëjt e ushqimit

Ministrja Frida Krifca ka vizituar këndine fëmijëve në Panairin e Bujqësisë në Sheshin "Nënë Tereza", ku me përkujdesje dhe vëmendje për sensibilizimin ndaj rrenjëjtëve të ushqimit, ka shoqëruar fëmijët gjatë procesit të mbjelljes së fidanëve nëpër vazo të voglatë përshtatshme për ta, si dhe u ka shpjeguar se sa e rëndësishme është toka dhe produktet e saj për të gjithë njerëzit dhe gjallesat e tjera. Fëmijët kanë mësuar të bashkëveprojnë me njëri -tjetrin gjatë procesit të mbjelljes me pas kanë vizatuar produktet e tyre të preferuara.



**INTEGRIMI**  
Takim me Komisionerin e Bujqësisë të Bashkimit Europian

Ministrja Frida Krifca është takuar në Bruksel me Komisionerin e Bujqësisë të Bashkimit Europian, Z. Janusz Wojciechowski, për të diskutuar të tashmen dhe të ardhmen e bujqësisë shqiptare. Në takim u diskutua për përfshirjen e Shqipërisë në mekanizmin e ngritur nga BE për përbalimin ndaj sfidave ushqimore që vijnë si pasojë e luftës në Ukrainë, për mbështetjen e ardhshme të Bashkimit Europian për Shqipërinë nëpërmjet programit IPARD III si dhe për thellimin e bashkëpunimit për rritjen e kapaciteteve të institucioneve tona në procesin e integritimit në Bashkimin Europian.